

VENDIM
Nr. 167, datë 19.3.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIM I RRUGËS ‘BEXHET HYTI’ NË ZONËN KADASTRALE 2654”, BASHKIA ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim i rrugës ‘Bexhet Hyti’, në zonën kadastrale 2654”, Bashkia Elbasan.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 936 355.66 (nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 936 355.66 (nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Elbasan.

8. Bashkia Elbasan kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Elbasan.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Elbasan, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrotjtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “NDËRTIM I RRUGËS ‘BEXHET HYTI’ NË ZONËN KADASTRALE 2654”, BASHKIA ELBASAN

NR.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM							SHËNIME(D+E) Kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)	
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	"Arë" (m²)	"Truall" (m²)	"Ndërtesë" (m²)	Volumi	Faqe	ARË		Vlera(lekë)	"TRUALL"		VLERA TOTALE (lekë)		
														Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)		Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)			Vlera (lekë)
1	Servet	Musa	Tanushi	Elbasan	2654	1157/3	Truall	250		250.00	104.50	3	89				13.50	269	3,631.50		
	Ilmie	Zenel	Tanushi																		
2	Faik	Musa	Tanushi	Elbasan	2654	1157/2	Truall	250		250.00	88.80	3	88				8.00	269	2,152.00		
	Ramazan	Musa	Duka																		
3	Haxhire	Mustafa	Duka	Elbasan	2654	1214	Arë+Truall	1000		172.73	152.60	1	97	3.80	222	843.60				843.60	
4	Fiqiret	Jakup	Muzhaqi	Elbasan	2654	6/2	Truall	289.5		289.50	128.10	1	33				9.44	269	2,539.36		
5	Petraq	Pandi	Guxho	Elbasan	2654	1480	Truall	20287		20,287.00	10,854.30	3	237				992.80	269	267,063.20	267,063.20	- Regj. 00820, datë 11.8.2021. Hipotekë ligjore së kredisë së dhënë nga institucione bankare. Nr. kont. 2010/945, datë 11.8.2021. 20 vjet. Banka e parë e investimeve Albania First Investment. - Regj. 00821, datë 14.6.2023. Hipotekë ligjore së kredisë së dhënë nga institucione bankare. Nr. kont. 3283/1988, datë 14.6.2023. 20 vjet. Banka e parë e investimeve Albania First Investment. - Regj. 00826, datë 14.10.2024. Hipotekë ligjore së kredisë së dhënë nga institucione bankare. Nr. kont. 5678/3353, datë 11.10.2024. 20 vjet. Banka e parë e investimeve Albania First Investment.
6	Durim		Peshtani	Elbasan	2654	1590	Truall	15364		15,364.00	875.00	3	222				2,454.00	269	660,126.00	660,126.00	
	Drita	Kadri	Gedaj																		
	Doraida	Flamur	Kafexhiu																		
	Ervin	Flamur	Gedaj																		
	VLERA TOTALE															843.60			935,512.06	936,355.66	